



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. Regj. Them. 11325/8536/4127/717 (31025-05213-86-2015) Nr. vendimi 3128 (86-2018-3503)
Data e Regjistrimit 30.07.2015 Data e vendimit 14.09.2018

V E N D I M
"NË EMËRTË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Apelit, e formuar si trup gjykues, në përputhje me parashikimet e nenit 12, pika 2, shkronja "a", të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (ligji Nr. 49/2012), nga gjyqtarët:

Amarildo	LAÇI	KRYESUES
Alkelina	GAZIDEDJA	ANËTARE
Bari	SHYTI	ANËTAR

Asistuar nga sekretarja gjyqësore, [REDAKTUAR] në Tiranë, sot në datë 14.09.2018, mori në shqyrtim në **dhomë këshillimi**, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit Nr. 49/2012, çështjen me Nr. 11325/8536/4127/717 (31025-05213-86-2015) akti, datë 30.07.2015, që iu përket:

PADITËS: [REDAKTUAR] i biri i [REDAKTUAR] banues në [REDAKTUAR] Rruga [REDAKTUAR]

E PADITUR: BASHKIA TIRANË.

PERSONI TRETË: KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI.

OBJEKTI:

- Diskriminim, përdorim arbitrar i pushtetit, fyerje dhe cenim të dinjitetit, tejkalim i kompetencave.
- Detyrimin e palës së paditur të më pajisë me lejen përkatëse të paraqitur disa herë në bazë të projektit dhe kërkesave të ligjit.
- Kthimin në vendin ku ishin vendosjen sërish në çati 90 m² panele sanduiç.
- Shpërblimi dëmi pastaror e jopastaror.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nënet 3, 17, 18, 15, 42, 2, 44 etj.; Neni 9 i Konventës Evropiane etj.; Kodi i Procedurës Civile, Nenet 31, 1, 32 a, 34, 37, 154 etj.; Kodi Civil 608, 609, 625 a, 640 etj.; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 1 të kësaj dhe nenet

përkatese si ato 1, 3, 6, 8, 10, 12 etj. Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 3157, datë 11.06.2015, ka vendosur::

- Rrëzimin e kërkesëpadisë.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi. Për palën në mungesë afati i ankimit fillon nga dita e nesërme e marrjes dijeni për këtë vendim.

Kundër këtij vendimi, në datë 19.06.2015, ka paraqitur ankim të shkurtër paditësi dhe ka sjellë plotësimin e ankimit më datë 03.08.2015 duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit Nr. 3157, datë 11.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe prurimin e padisë:

- Gjykata nuk ka garantuar një hetim të plotë të provave dhe fakteve që ndodhen në dosje. Ajo ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme bazën juridike të mosmarrëveshjes. Nuk ka ofruar dhe rekomanduar asnjë mundësi për një mënyrë të pranueshme të kësaj mosmarrëveshjeje për zgjidhje, qoftë edhe të përkohshme.
- Provat shkresore dhe 4 ekspertiza që ndodhen në dosje, aktet zyrtare etj. kanë fuqi provuese, kanë formën e kërkuar nga ligji, janë përpiluar nga nëpunësi i shtetit brenda kufijve të kompetencës së tyre, pavarësisht se Gjykata nuk e ka detyrim ligjor në bazë të ligjit është e detyruar të arsyetojë në mënyrë të hollësishme mendimin e vet, kundra.
- Nuk është respektuar parimi i sigurisë juridike që d.m.th. garantim i besueshmërisë së individit të shteti dhe institucioneve të tij dhe akteve që ato nxjerrin.
- Gjykata nuk ka respektuar parimin e paanësisë në gjykim pa dhënë argumente ligjore bindëse.
- Gjykata në shkelje flagrante të kompetencave që i njeh ligji dhe funksionit që ajo kryen, i ka dhënë të drejtë Administratës Publike dhe kompetencat e veta për të dhënë drejtësi.
- Ajo në vendimin e saj gjithashtu në shkelje flagrante edhe me protokollin ndërkombëtar në këtë rast veçanërisht Nenin 12 të Protokollit Shtesë të Konventës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i ka dhënë drejtësi veprimeve arbitrare që d.m.th. i ka dhënë nderit, personalitetit dhe dinjtetit tim, duke cenuar rëndë jetën time private dhe familjare.
- Ajo me çdo kusht duhet të jepte të argumentuara mirë përgjigjet e këtyre pyetjeve kryesore që përbejnë thelbin e diskriminimit, arbitraritetit, tejkalimit të kompetencave etj. A përthatet ndërhyrja e autoritetit publik në këtë rast, të dhunimit pa shkak të banesës, të jetës private, shkatërrimit të saj në mënyrën me demonstrative dhe publike, si mundet gjykata të konsiderojë këto veprime, si ngjarje episodike? A përbën ky veprim i autoritetit publik një qëllim të ligjshëm? A është kjo e domosdoshme në shoqërinë tonë demokratike një ndërhyrje e tillë brutale e vetë shtetit? Çfarë ndikimi do të shkaktojë dhe do të ndikojë në integritetin tim moral e fizik këtë veprim të autoritetit publik (shtetit) për të garantuar jetën time private që tam për mua ja të dhur dhe kurë ndikuar diska në shëndetin tim mendor.
- Duke u rikthyer në këto fakte nën krysimin e këtyre fakteve, veprimet dhe mosveprimet të shtetit dhe administratës së saj, ju lutem t'ju tregojë më qartë se kjoq, diskriminim, Çfarë detyrë të më tepër se kjoq, shkakton arbitrariteti.

Çfarë do të thotë më tepër se kaq cenim të dirijetit dhe personalitet të individit, cenim të jetës private dhe familjare.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin e datës 19.06.2015, ka verifikuar kushtet e pranueshmërisë së ankimit, në zbatim të kërkesave të nenëve 46 e 48 të ligjit nr. 49/2012, dhe në përfundim ka vendosur: Pranimin e ankimit të palës paditëse, Fisnik Pula.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Në dhomë këshillimi, si verifikoi se ankimi plotësonte kushtet e pranueshmërisë, në vështrim të nenit 46(2) të ligjit Nr. 49/2012:

konstatoi se palët ndërgjyqëse kishin dijeni rregullisht për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shqyrtimit të çështjes, me shpalljen e datës 24.07.2018, në konformitet me përcaktimet e nenit 49(2), fjalja e dytë, të ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 482(2) të K.Pr.Civile:

pasí u njoh me *relacionin e përgatitur nga gjyqtari Amarildo Laçi*,

dhe e shqyrtoi çështjen, brenda shkaqeve të ngritura në ankim, në përputhje me normat ligjore relevante materiale e procedurale,

V Ë R E N:

Vendimi Nr. 3157, datë 11.06.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, që ka rrëzuar kërkesëpadinë e paditësit, [REDAKTUAR] duhet të libet në fuqi, në përputhje me gemën "b", të nenit 50 të ligjit Nr. 49/2012, por me disa shtesa në arsyetimin e vendimit.

I. Rrethanat e çështjes:

Paditësi [REDAKTUAR] sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 07.06.2013, është pronar mbi një ndërtesë me sipërfaqe 122 m², me nr. pasurie [REDAKTUAR], ndodhur në zonën kadastrale (ZK) [REDAKTUAR] volum [REDAKTUAR], faqe [REDAKTUAR], ndodhur në qytetin e Tiranës, rruga [REDAKTUAR]. Këtë pasuri paditësi e fituar me kontratë dhurimi, sipas shënimit të vënë në kartelën e pasurisë.

Paditësi është pronar edhe i dy apartamenteve me sipërfaqe 33.75 m² dhe 16 m², të ndodhur në qytetin e Tiranës, rruga [REDAKTUAR]. Apartamenti prej [REDAKTUAR] m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 07.06.2013, është regjistruar si pasuri me nr. [REDAKTUAR] në ZK [REDAKTUAR] volum [REDAKTUAR], faqe [REDAKTUAR] dhe është fituar nga paditësi me kontratë dhurimi. Ndërsa, apartamenti prej 16.00 m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie të datës 20.05.2013, është regjistruar si pasuri me nr. [REDAKTUAR] të ndodhur në ZK [REDAKTUAR] volum [REDAKTUAR], faqe [REDAKTUAR] dhe është fituar nga paditësi me kontratë dhurimi.

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik (INU) i Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 169, datë 28.11.2011, ka vendosur pezullimin e punimeve të kryera nga paditësi, [REDAKTUAR] në banesën në rrugën [REDAKTUAR], që lidheshin me ndërtimin e katit të dytë dhe që ndodheshin në fazën e mureve e anësore. Ndërkaq me vendimin nr. 549, datë 23/11/2011 INU i Bashkisë Tiranë e ka dënuar edhe administrativisht me gjobë paditësin për kryetjen e kundërvajtjes në fushën e ndërtimit (ndërtim pa leje), në masën 708 325 lekë.

Në gjykim është provuar se paditësi i është drejtuar disa herë Bashkisë Tiranë duke kërkuar leje për rikonstruksion banese, për riparimin e çatisë së godinës së banimit, për shtesë banese dhe për riparimin e çatisë së banesës së tij, pa prekur konstruksionin e saj. Këto kërkesa janë refuzuar nga pala e paditur, për shkak se Këshilli Bashkiak nuk kishte miratuar Instrumentin Vendor të Planifikimit për Bashkinë e Tiranës dhe pas datës 22.08.2014, dhënia e lejeve të ndërtimit është pezulluar me vendimin nr. 1, datë 22.08.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, deri në konstituimin e organeve të reja përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

a) Pretendimet e paditësit,

Paditësi [REDAKTUAR] pretendon se banesa ku ai jeton është shumë e amortizuar. Për të provuar këtë fakt paditësi paraqiti në gjykim shkresat nr. 2730 prot., datë 21.11.2011 dhe nr. 2875 prot., datë 03.12.2013, të Njesisë Bashkiake Nr. 1, pranë Bashkisë Tiranë.

Paditësi ka pretenduar se, i është drejtuar me disa kërkesa Bashkisë së Tiranës për t'i dhënë leje për rikonstruksionin e saj, por ato nuk janë marrë parasysh. Për më tepër, nga Policia Bashkiake Tiranë paditësi është dënuar me gjobë dhe i është prishur çatia, duke iu marrë 90 m² panele sandaiç, me pretendimin se ai po ndërtonte me leje.

Sipas paditësit ky qëndrim i ndërtimit, arbitrar, diskriminues dhe në kapërcim të kompetencave ligjore nga Bashkia e Tiranës dhe Policia Bashkiake i kanë sjellë atij dëm pasuror e jopasuror, i cili duhet të dëmshpërblehet nga pala e paditur.

Paditësi ka pretenduar se, në bazë të kontratës së huasë me nr. 1064 rep. dhe me nr. 2631 kol., datë 25/11/2011, ai i ka marrë hua shtetases [REDAKTUAR] shumën 25.000 USD. Ndërkohë që shtetasit [REDAKTUAR] i ka marrë shumën prej 30.000 euro, sipas marrëveshjes së premtimit me nr. 1504 rep. dhe me nr. 301/1 kol., datë 22/11/2012.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, paditësi, [REDAKTUAR] ka pretenduar se, ndaj tij ka ndodhur diskriminim për shkak të pushtetit arbitrar të palës së paditur. Ai pretendon se është cenuar në pasurinë dhe në personin e tij nga sjellja e palës së paditur. Nga veprimet e palës së paditur, sipas paditësit, i janë marrë sendet nga ndërtimi dhe panele sandaiç. Paditësi ka pretenduar t'i kthehen sendet e marra, të pajiset me leje përkatëse për vazhdimin e punimeve, të dëmshpërblehet për dëmin moral e dëmin pasuror.

Mbi kërkesën e paditësit gjatë gjykimit në shkallë të parë janë kryer tre akte ekspertimi: (i) në fushën e ndërtimit; (ii) psikologjik dhe (iii) kontabël.

Sipas të dhënave të gjetor akteve të ekspertimit teknik në fushën e ndërtimit, prona e paditësit përbëhet nga një ndërtesë e vjetër njëkatëshe dhe një ndërtim i ri, dykatësh, e ndërtuar mbi banesën e vjetër, po pa mbulesën e kati të dytë. Objekti dykatësh ka qenë i mbuluar me panele sandaiç, me sipërfaqe 90 m², por Policia Bashkiake ia ka prishur, si ndërtim pa leje. Paditësi i është shprehur ndërsa e vjetër dhe ai ka ndërtuar një shtesë anësore dykatëshe në veri të banesës së vjetër, të ndërtuar me mur tulle. Sipërfaqja e ndërtimit pa leje nga paditësi është 115 m², ndërsa sipërfaqja totale ndërtimore është 288 m². Sipas ekspertit vlerë e këtij ndërtimi, e llogaritur sipas kostonë së Firatit Kombëtar të Banesave, është 9.203.904 lekë.

Ekspertimi psikologjik i paditësit ka arritur në përfundimin se, paditësi [REDAKTUAR] nga prishja e një pjese të shtëpisë në dhjetor 2011, i është shkaktuar një dëm moral, duke ndikuar në mirëqenien e tij familjare, sociale dhe emocionale.

Paditësi, [REDAKTUAR] duke u bazuar edhe në përfundimet e akteve të ekspertimit, ka kërkuar të dëmshpërblehet nga Bashkia Tiranë me 7.500 lekë në dhë, për dëmin pasuror dhe moral të pësuar, duke filluar nga data 23.11.2011, deri në marrjen formë të prerë të vendimit, si dhe një interes mujor prej 2%.

Në përgjigje të pretendimeve të paditësit, ekspertja kontabël ka konstatuar se, shumën e kërkuar nga paditësi për periudhën kohore 23.11.2011-26.05.2015, është në shumën 9.600.000 lekë, ndërsa përqindja mujore në vlerën 192.000 lekë.

β) Prapësimet e palës së paditur, Bashkia Tiranë:

Pala e paditur, Bashkia Tiranë, duke kërkuar rrëzimin e padisë, ka prapësuar se:

Së pari: Nga pala paditëse pretendohet për diskriminim, lëvizje dhe cenim dinjiteti nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë. Ky pretendim nuk qëndron për arsye të më poshtë vijon: Bashkia Tiranë, bazuar në korrespondencën e mbajtur me paditësin, [REDAKTUAR] paraqitur si provë para gjykatës, i është përgjigjur brenda afateve dhe e ka sqaruar paditësin. Paditësi pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e bashkisë, por faktet dhe provat që ne kemi paraqitur tregojnë të kundërtën.

Drejtoria e Përvuithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i është përgjigjur dhe ka sqaruar [REDAKTUAR] për çdo pyetje dhe kërkesë të tij, me shkresën me nr. prot. 8475/1, dt. 18.07.2014; shkresën me nr. prot. F-9864/2, dt. 12.09.2014; shkresën me nr. prot. F-10163/1, dt. 14.08.2014; shkresën me nr. prot. F-5259/1, dt. 30.05.2013; shkresën me nr. prot. F-4340/1, dt. 18.04.2013. Pra nuk kemi para një veprimi diskriminues apo fytes nga ana e Bashkisë Tirane.

Së dyti: Paditësi pretendon se nuk e ka marrë përgjigje, nga ana e bashkisë, por edhe në rast se do të provohen shkelje procedurale, referuar nenit 40 të ligjit 49/2012, ato janë të tilla që nuk do të sillnin një rezultat të ndryshëm, për shkak të kërkesave të pabazuara të paditësit.

Së treti: Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në përgjigje të shkresës me nr. prot. 14/F, datë 04.06.2014 të Institucionit të Presidentit të Republikës i është përgjigjur si me poshtë:

"Siç ju kemi sqaruar edhe më parë në mënyrë të përsëritur verbale dhe me anë të shkresave nr. prot. F-10163/1, datë 14/08/2013, nr. prot. F-5259/1, datë 30/05/2013 dhe nr. prot. F-4340/1, datë 18/04/2013, në varësi të kërkesave të ndryshme që ju kemi paraqitur pranë Bashkisë së Tiranës për riparim mbulesë godine, për riparim pjesor godine dhe për shtesë anësore në godinën nr. [REDAKTUAR] në rrugën [REDAKTUAR], në datë 30.05.2011 kanë hyrë në fuqi ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar); "Rregullorja uniforme e instrumenteve të planifikimit", miratuar me VKM nr. 481, datë 22.06.2011 (i ndryshuar) dhe "Rregullorja uniforme e kontrollit të zhvillimit të territorit", miratuar me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 (i ndryshuar).

Përsërisim se, nëse parimet e riparimit që ju kërkojmë të kryeni nuk ndërhyjnë në strukturën e objektit ekzistues, për të cilin duhet të paraqisni vërtetimin hirotektonik, mund të bëni kërkesë pranë Bashkisë së Tiranës për "Deklaratë për kryerje punimesh për mirëmbajtje", sipas nenit 70/33 të ligjit nr. 101/19, datë 23.04.2009 për "Planifikimin e

territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij duke shoqëruar aplikimin me dokumentacionin tekniko ligjor sipas listës bashkëlidhur.

Nëse punimet e rikonstruksionit që kërkon të kryeni ndërhyjnë në strukturën e objektit ekzistues, për të cilin duhet të paraqisni vërtetimin hipotekor, mund të bëni kërkesë për "Leje zhvillimore të veçantë", sipas nenit 70.7 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 për "Planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij duke shoqëruar aplikimin me dokumentacionin tekniko ligjor sipas listës bashkëlidhur.

Gjithashtu ju sqarojmë se, nëse kërkon të realizoni shtesë anësore në godinën nr. [redacted] në rrugën [redacted], punimet që kërkon të kryeni klasifikohen në rastet që parashikon neni 70/5 "Leje zhvillimore ndërtimi" i ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar). Aktualisht, kërkesat për punime të cilat pajisen me leje zhvillimore ndërtim nuk mund të shqyrtohen deri në hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor të rën njësisë strukturore 1/40."

Gjithashtu paditësi pretendon dëmshpërblim dëmi moral dhe pasuror nga ana e Bashkisë Tiranë, gjë që të cilën deri tani nuk e ka provuar me fakte dhe prova që Bashkia e Tiranës është subjekti që ka sjellë dëmet që paditësi pretendon.

II. Arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë (gjykata e shkallës së parë) në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes ka marrë vendimin përfundimtar Nr. 3157, datë 11.06.2015, me të cilin ka vendosur të rëzohet padinë.

Gjykata e shkallës së parë, në pjesën relevante të vendimit ka arsyetuar si më poshtë (infra):

"[...] Gjykata thekson se, padia e paraqitur është një padi që paraqet disa problematika ligjore. Gjykata i analizon këto momente si më poshtë.

1. Sjellja e paligjshme e palës së paditur dhe fakti i paligjshëm!

Pala paditëse që në gjenezë të konceptimit të kërkesëpadisë pretendoi se në sjelljen e palës së paditur ka paligjshmëri. Ajo është e rëndësishme theksohet është fakti se sjellja e organit publik munit të shfaqet në format sidomos nëse pretendohet për paligjshmëri që ajo mund të shfaqet edhe në kuadër të një sullmeti, por edhe në kuadër të gjendjes faktike.

Në rastin konkret nga pala paditëse ka një paradoks, pasi në një kohë që pretendon paligjshmëri të sjelljes së palës së paditur dy aktet e vetme që gjykata, por dhe patet disponojnë të palës së paditur janë vendimi për pezullimin e punimeve apo dhe vendimi për ndalshkimin administrativisht të paduesit me gjuhë. Pra pala paditëse pranon vlefshmërinë e akteve që kanë konstatuar ndërtim edhe duke bërë me katin e dytë të banesës ku paditësi jeton. Për më tej këto akte kanë vendit për pezullimin e punimeve dhe ndalshkimin e paduesit me gjuhë. Paditësi, është vërejtur të akteve të cilat janë të vlefshëm menjëherisht për një kohë të vjetër e tyre paditësi nuk është venura, por akte të mbyllurshëm apo akte me vendim gjykatës.

Në një situatë të akteve e palës së paditur që kanë konstatuar ndërtimin e katin të dytë nga pala paditëse dhe që kanë vendit për pezullimin e punimeve dhe ndalshkimin e paditësit me gjuhë në fakt. Në konstatim paligjshmëritë e palës së paditur në raport me këto akte."

Pra është shumë e rëndësishme të kemi një veprimtari administrative të kundraligjshme. Në rastin konkret ky element i dëmit nuk rezultoi i provuar në kuadër të shqyrtimit të padisë. Pasi paditësi në mënyrë apriori kërkon që të përfaqësojë origjinen dëmit të menduar prej tij si dëm në pasuri tek veprimtaria e paligjshme e palës së paditur ka respektivisht ngre pretendime për aktet e palës së paditur duke i konsideruar ato vet ai si të paligjshme në një kohë që për shkak të ligjit ato janë akte të vlefshme juridikisht sepse vlera e tyre juridike nuk është cenuar me akt.

Gjykata në kuadër të identifikimit të shkakut që ka sjellë këtë dëm tek paditësi nuk është dakord me këtë mënyrë të konceptuarit të padisë nga paditësi. Pasi është shumë e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin objekt verifikimi fakti i paligjshëm identifikohet si veprimtari administrative e paligjshme.

Në këtë lloj gjykimi nuk mund të ngrihen apriori dhe në çdo kohë jashtë kritereve pretendime për paligjshmëri të veprimtarisë administrative. Pasi fakti i paligjshëm në rastin konkret është ekuivalent me koncept të veprimtarisë administrative të paligjshme.

Është e vërtetë se pretendimi për dëmshpërblim nga jashtëkontraktor mund të ngrihet në çdo kohë, por pretendimet paligjshmëri të veprimtarisë administrative nuk mund të ngrihen në çdo kohë dhe në çdo formë. Ajo nuk mund të verifikohet e shkëputur nga rregullat e verifikimit të gjykatës në këtë veprimtari administrative.

Si mund gjykata të konstatojë në këtë lloj padie në këtë lloj gjykimi në këtë kuadër provash se aktet e pacenuara që konfigurujnë veprimet administrative të palës së paditur janë ende në fuqi dhe të vlefshme. Në çdo rast dhe për asnjë lloj arsye nuk mund të pretendosh paligjshmëri të veprimtarie administrative në një kohë që veprimtaria administrative të cilën paditësi kundërshton për shkak të ligjit prezumohet e ligjshme.

Pra specifika e rastit: kërkon që paligjshmëria sjellja në kundërshtim me ligji në rastin konkret mendohet të jetë e palës së paditur organ publik e cila ka vepruar në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë dhe kompetencave të caktuar me ligj. Në këtë logjikë të pretendosh se kjo veprimtari bie ndesh me ligjin duhet që të merret në shqyrtim dhe të analizohet ligjshmëria apo paligjshmëria e akteve në të cilat kjo veprimtari është konfiguruar. Kjo gjë nuk është bërë më parë në kohë dhe nuk është objekt gjykimi.

Pra pretendohet paligjshmëri veprimtarie administrative në një kohë që paligjshmëria duhet të rezultojë e provuar në gjykim, ashtu si ligji i kërkon. Të gjitha pretendimet e palës paditëse që të analizojë dhe të konkludojë nëpërmjet kësaj padie se aktet nëpërmjet të cilës pala e paditur ka vepruar administrativisht janë të paligjshme është një devijim nga ligji dhe pamundësi ligjore absolute për t'u bërë në këtë gjykim. Për atë kohë veprimtaria administrative e palës së paditur mbi të cilën rëndojnë pretendimet e palës paditëse është një veprimtari administrative mund të pretendohet të verifikohet ligjshmëria e kësaj veprimtarie nëpër kësaj padie pa u goditur me padi ligjshmëria e vetë veprimtarie administrative.

Një moment i dytë i faktit të paligjshëm dhe që është shumë e vështirë është fakti se paditësi pretendon shkatërrim të pronës së tij në formën dhe mënyrën që ai pretendon, thyrje në banesë, heqje e paneleve sunditë etj. Por ky moment si gjendje fakti që është duhet të provohet në gjykim në mënyrë të drejtpërdrejtë para gjykatës nga paditësi.

Duke parur parasysh raportin pretendime - propozime të palës së orgaqëve, vlerën provuese të akt - konstatimit, pretendimet e ngritura nga jua paditëse bëhen me këtë akt.

gjykata çmon se pretendimi sie banesa ndertimi prona me është shkatërruar dëmtuar nga pala e paditur është një pretendim që duhet të ngrihet në formën e kërkuar nga ligj dhe të mbështet në një fakt formues që sjellë lindjen e të drejtës së paditësit. Ku për rrjedhoje dhe duke patur parasysh raportin e institutit të barrës së provës të përcaktuar nga ky ligj i posaçëm dhe Kochi (e Procedures Civile ky fakt (jo çështje ligji) formues (sjellë lindje të së drejtës së palës paditëse) duhet të provohet në gjykim nga pala paditëse.

Pala paditëse nuk paraqiti në këtë gjykim asnjë provë të vetme që të provojë se autorësia e ngjarjes së ndërtuar është e palës së paditur. Pra jo vetëm që ecuria deri në momentin i pezullimit dhe ndëshkimit administrativisht të palës paditëse është situatë e pacënuar ligjërisht nga paditëse dhe e vlefshme juridikisht, por këto akte konfirmojnë se paditësi nuk ka qenë në rikonstrukton të banesës së tij, por në një ndërtim për një shtese kati dhe pikërisht për këtë është ndëshkuar. Por nuk rezulton se në një kohë të dytë të ketë akte apo të ketë prova që provojnë se dëmi i menduar si ardhur në banesën e tij të ketë ardhur nga sjellja e palës së paditur.

Pra jo vetëm që në çdo rast jemi para një organi publik dhe me akte të vlefshme që konfirmojnë të kundërtën e asaj cka paditësi pretendon të provojnë paligjshmëri të sjelljes së palës paditëse dhe në asnjë rast nga provat nuk provohet paligjshmëri sjellje e palës së paditur apo së pala e paditur ka kryer një veprim të paligjshëm.

Në këtë moment gjykata thekson se nuk provohet as mënyra sesi paditësi i parashtron pretendimet si bazë e panelev standit. Këto jone ngjarje episodike pjesë të faktit të paligjshëm i cili në tërësinë tij nuk provohet.

2. Detyrimin të marrë me leje respektive për rikonstruktonin e banesës.

Pala paditëse edhe në këtë kontekst ka një handicap pasi nuk vërehet korelacion ndërmjet kërkesës së tij për leje për konstrukton banese, përgjigjes kthyer nga pala e paditur dhe kërkesëpaditëse. Pala paditëse, ashtu edhe si pretendon, por edhe se provohet ka paraqitur pranë palës së paditur kërkesë për t'u pajisur me leje për rikonstruktonin e banesës. Në kuadër të kësaj kërkesë paditësi ka marrë dhe përgjigje për çdo rast që ai ka kërkuar lejen, edhe pse ka marrë përgjigje nuk godet aktet në të cilën pala e paditur ka pasqyruar vullnetin e saj për mosdhënie e lejes. Por kërkon që të realizojë të drejtën e tij në këtë formë duke nxjerrë apriori pasojën e tij të menduar si të nevojshme në plan të parë pa kontestuar vullnetin e palës së paditur shprehur në aktet respektive.

Në kohën që paditësi ka aplikuar për leje kishitë hvrë në fuqi ligji "Për planifikimin e territorit" nr. 16/19 date 23/01/2009,

... Pra në çdo rast pala paditëse duhet të kërkojë marrjen nga pala e paditur të këtij akti vendim apo kane vrshtimi e tij në gjykatë. Por në asnjë rast nuk mund të kërkojë t'i jepet leja nga gjykata pa patur vërdimtarri. Gjykata e thekson këtë moment pasi është shumë e rëndësishme për të vijën e daktur të tij. Pasi kjo mënyrë parashtrimi pretendon është jo e duhura për paditësin [sense] shprehë mundësinë e verifikimit të gjykatës se marrëmbësveshies brenda afatit të daktur ligjore këtu zgjidhë mbipike të çështjes dhe jo ligjore.

Pra të gjithë marrëmbësveshies me një gjykata konkludon se asnjë rezultat gjykatës i faktit dhe paligjshmëria e të kundërt nga pala paditëse. Si rrjedhojë nuk ka vlerë as për kërkimin për dëmtim përblim në favor të palës paditëse dhe në rastin konkret edhe qenë se nuk e çështjeve

fakti i paligjshëm, atëherë nuk mund të kundërdrejtohet ndal palës së paditur pretendim për dëm të ardhur nga sjellja e saj.

Në lidhje me çështjen nëse është rasti për caktimin e ndonjë shume të hollash me titull dëmshpërblimi për pësimin e një dëmi pasuror. Gjykata arrin në përfundimin se, për shkak se nuk u provuan sjellja juridike dhe faktike e paligjshme e palës së paditur dhe shkakimi i dëmit nuk bën sens dëmshpërblimi i palës paditëse.

Sa më lart, Gjykata, në përfundim të kësaj analize ligjore të fakteve objekti verifikimi duke vlerësuar kërkimet e palës paditëse, qëndrimin e palës së paditur, raportin shkak ligjor - bazë juridike objekti kërkimesh, pasi çmoi provat e marra në gjykim, vendos të rrëzojë kërkesëpadinë, si të pabazuar në ligj dhe në prova.”

Vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar nga paditësi, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, për shkaqet e listuara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata Administrative e Apelit (Gjykata e Apelit/kolegji) çmon se, gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur për rrëzimin e padisë, për motivet që do të renditen më poshtë:

Në gjykim është provuar se paditësi, në muajin nëntor 2011, po ndërtonte pa leje të organeve kompetente shtetërore një shtesë anësore dykatëshe në veri të banesës së vjetër, të ndërtuar me mur tulle, të ndodhur në rrugën Tiranë. Akti i ekspertimit teknik në fushën e ndërtimit, i kryer gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka provuar se, ndërtimi pa leje i paditësit ishte dykatësh, i ndërtuar mbi banesën e vjetër, po pa mbulesën e katit të dytë. Objekti dykatësh ka qenë i mbuluar me panele sanduiç, me sipërfaqe 90 m². Sipërfaqja e ndërtuar pa leje nga paditësi është 115 m², ndërsa sipërfaqja totale ndërtimore është 288 m².

i) Në lidhje me pretendimin e paditësit për paligjshmërinë e veprimeve të INU të Bashkisë Tiranë

Paditësi ka pretenduar se nga veprimet e paligjshme të INU, Bashkia Tiranë, që i ndërpreu punimet dhe i prishi çatinë e katit të dytë atij i është shkaktuar dëm pasuror (në vlerën e panelit sanduiç prej 90 m²), si dhe dëm moral.

Në gjykim është provuar se, INU e Bashkisë Tiranë, pasi ka konstatuar ndërtimin pa leje të paditësit, me vendimin nr. 169, datë 28.11.2011, ka vendosur pezullimin e punimeve të kryera nga paditësi, Fisnik Pula, në banesën në rrugën Tiranë, që lidheshin me ndërtimin e katit të dytë dhe që ndodheshin në fazën e murave e anësore. Njëherësh, INU i bashkisë, me vendimin me nr. 549, datë 23.11.2011, e ka cënuar edhe administrativisht me gjobë paditësin për kryerjen e kundërvajtjes në fushën e ndërtimit (ndërtim pa leje), në masën 708 325 lekë.

Gjykata e Apelit evidenton se, paditësi nuk vërtetoi në gjykim se i kishte kundërshtuar gjyqësisht akte administrative të mësi bërme, vendime të INU të Bashkisë Tiranë.

Këto vendime rezultojnë të ketë reflektuar kuadrin ligjor në fuqi, në momentin e disponimit të tyre, konkretisht dispozitat e ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit".

Në nenin 14 të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", parashikohet se:

"Kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë komunës/qarkut për marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozita ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Kundër vendimeve të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Në rast se, në bazë të vendimit përfundimtar të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar".

Rrjedhimisht, në kohën e ngritjes së padisë sipas ligjit "Për inspektimin e ndërtimit", konfirmohet kushitë e ngritjes së padisë për dëmshpërblim, vetëm pas zgjidhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë, të pretendimeve për paligjshmëri të vendimeve të INU të bashkisë.

Paditësi [REDAKTUAR] ka investuar gjykatën pa e zgjidhur paraprakisht në rrugë gjyqësore, çështjen e ligjshmërisë së këtyre vendimeve të INU të Bashkisë Tiranë. Ende pa e vënë në diskutim gjyqësisht ligjshmërinë e Vendimeve 169, datë 28.11.2011 dhe nr. 549, datë 23/11/2011, të Kryeinspektorit të INU të Bashkisë Tiranë, paditësi, me pretendimin se aktet administrative janë të paligjshme, ka investuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar, heqjen e panelit sanduic prej 90 m² dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë ta vendosë sërish në vend këtë panel, krahas dëmit moral.

Rrjedhimisht, sa i takon situatën faktike në kohën e ngritjes së padisë së shqyrtuar me vendimin objekt ankimi, rezultojnë se *praktika e pezullimit të punimeve, prishjes së çatisë së katit të dytë të ndërtimit pa leje dhe dëmtimit administrativ me gjobë, lidhur me kundërvajtësin Vesnik Pota, rezultojnë e mbyllur me vendime administrative të formës së prerë, të paankonnuara në gjykatë nga të pandryshuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

Pikërisht, në bazë të këtyre të dhënave faktike, kolegji i vlerëson të pabazuara pretendimet e paditësit për dëmin dëmi pasuror e jopasuror nga veprimet e INU të Bashkisë Tiranë.

Një motiv më shumë për rrezikun e kërkuarve të paditësit për shpërblimin e dëmit të pësuar prej tij nga veprimet e INU të Bashkisë Tiranë, është se ajo palë nuk është thirrur në gjykim në cilësimet e të paditurit.

Gjykatat e Apelit vlerësojnë veprimet e INU pranë bashkisë të regjistruara me ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit". Në nenin 14 të këtij ligji, filluar me organizimin e inspektoratit ndërtimor është parashikuar se:

"Kontrolli e zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës kryhet nga"

1. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë komunës."

Kurse lidhur me përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë, në nenin 4 të ligjit në fjalë është parashikuar se:

"Pranë çdo bashkie komunë ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë komunës.

Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë komunës.

Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë komunës.

Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë komunës mbështetet nga policia bashkiake komunale dhe pajiset me mjetet dhe makinerite e nevojshme nga bashkia komuna."

Në analizë të këtyre dispozitave konstatohet se, INU funksionon pranë Bashkisë, por është strukturë e veçantë dhe gëzon personalitet juridik me vete nga bashkia. Kjo strukturë ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë. Pikërisht, në zbatim të këtyre detyrave INU Bashkia Tiranë ka nxjerre edhe aktet administrative ndaj paditësit [REDAKTUAR]

Bashkia e Tiranës, edhe pse Inspektorati Ndërtimor Urbanistik është organizuar dhe funksionon me vendim të këshillit bashkiak të saj, nuk ka asnjë pushtet shfuqizues apo revokues mbi vendimet e nxjerra nga inspektorët apo kryeinspektori i INU-së. Vendimet e këtyre të fundit mund të atakohen vetëm në gjykatën administrative e cila ka kompetencën për t'i shfuqizuar eventualisht ato, në rast se i gjen të pavlefshme, të pathemelta apo të pabazuara në ligj.

Në analizë të sa më sipër, pretendimet e ngritura në ankim nga paditësi [REDAKTUAR] për paligjshmëri të veprimeve të INU të Bashkisë Tiranë, që i kanë sjellë dëm atij, mbetet të pavërtetuara në gjykim dhe për pasojë janë të papranueshme.

ii) Në lidhje me pretendimin e paditësit për paligjshmërinë e mosvërtimit të palës së paditur, Bashkia Tiranë, për dhënien e lejeve të kërkuara nga paditësi

Gjykimi i çështjes provoi se paditësi [REDAKTUAR] pasi i ndërpreu nga INU i Bashkisë Tiranë, ndërtimi dykatësh pa leje që po ndërtohej prej tij, ka kërkuar dëse herë pranë palës së paditur, Bashkia Tiranë, që të pajisë me leje ndërtimi, konkretisht:

- a) Me kërkesat F 18019 prot. dhe F 18301 prot., paditësi ka kërkuar të pajiset me leje ndërtimi për rikonstruksion banese, por pala e paditur me shkresën Nr. F 18019/1 prot. dhe F 18301/1 prot., të datës 28.12.2011, ka refuzuar tëshim në saj, pasi në bazë të nenit 41 të ligjit nr. 10119/2009, organi përkatës i njësi së qeverisjes vendore nuk ka miratuar Instrumentin Vendor të Planifikimit për Bashkinë e Tiranës, ndaj në zbatim të nenit 75 të të njëjtit ligj, dhënia e lejes së ndërtimit është e pamundur.

- b) Të njëjtën përgjigje i ka dhënë Bashkia Tiranë paditësit, [REDAKTUAR] me shkresën nr. F-9365/1 prot., datë 05.07.2012, se dhënia e lejes së ndërtimi për rikonstruksion banese është e pamundur, për sa kohë nuk është miratuar Instrumenti Vendor i Planifikimit për Bashkinë e Tiranës, sipas nenit 74/8 të ligjit nr. 10119/2009.
- c) Me kërkesën F-4340 prot., datë 12.03.2013, paditësi ka kërkuar leje për riparimin e çatisë së godinës së banimit, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. F-4340/1 prot., datë 18.04.2013, e ka refuzuar këtë kërkesë, pasi për këtë ndërtim kërkohej leje ndërtimi, pasi ndërhynte në sistemin konstruktiv të banesës. Leje të tilla, sipas bashkisë, nuk mund të jepen pa u miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë. Gjithsesi paditësi orientohet që për punimet që kërkon të kryejë dhe që nuk ndikojnë në sistemin konstruktiv të banesës (mirëmbajtje dhe riparim strukture), të paraqesë në bashki deklaratën për kryerjen e punimeve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" dhe akteve nënligjore.
- d) Me kërkesën nr. F-5259 Prot., datë 28.03.2013, paditësi ka kërkuar leje për shtesë banese, të ndodhur në rrugën [REDAKTUAR], Bashkia Tiranë, me shkresën nr. F-5259/1 prot., datë 30.05.2013, e ka refuzuar këtë kërkesë, pasi leja e ndërtimit nuk mund të jepet pa u miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, si dhe pa u hartuar Planet e Detajuara Vendore në zonat përkatëse.
- e) Paditësi ka kërkuar leje për riparimin e çatisë së banesës së tij, pa prekur konstruksionin e saj, me kërkesën nr. F-10163 prot., datë 07.06.2013, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. F-10163 prot., datë 14.08.2013, e ka vënë në dijeni paditësin se një punim i tij nuk ka nevojë për leje ndërtimi, por vetëm për paraqitjen nga paditësi të një "Deklarate për kryerje punimesh mirëmbajtje" pranë Bashkisë Tiranë, sipas nenit 70/33, të ligjit nr. 10119/2009.
- f) Në përgjigje të shkresës së paditësit drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. F-9364/2 prot., 12.09.2014, i ka rikonfirmuar paditësit përgjigjet e tre shkresave të mësipërme, duke e informuar se ndërkohë kishte hyrë në fuqi edhe vendimi nr. 1, datë 22.08.2014, i Këshillit Kombëtar të Territorit, i cili në pikën 3 të tij pezullonte dhënie e lejeve të ndërtimit, si dhe miratimin e Planeve të Detajuara Vendore nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, deri në konstituimin e organeve të reja përfaqësuese dhe ekzekutive të njësite të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

Gjykata e Apelit, ndër she nga sa ka pretenduar në ankim paditësi, [REDAKTUAR], vlerëson se në sjelljen e palës së paditur, Bashkia Tiranë, nuk vërehet paligjshmëri dhe as faj, në trajtimin e kërkesave të paditësit.

Ky kolegji çmon të evidentojë faktin se, paditësi, pasi dështoi të ndërtonte pa leje ndërtimin dykatësh, me pretendimin se banesa ka jetonte ishte amortizuar dhe ishte në rrezik shembje, i është bërë tarr me disa kërkesa Bashkisë Tiranë, duke kërkuar, fillimisht, leje për rikonstruksion banese, më pas për riparimin e çatisë së godinës së banimit, në vijim për shtesë banese dhe në fund për riparimin e çatisë së banesës së tij, pa prekur konstruksionin e saj.

Pala e paditur, i ka refuzuar, sëro kërkesa, duke arsyetuar në thelb se, Këshilli Bashkiak nuk kishte miratuar Instrumentin Vendor të Planifikimit për Bashkinë e Tiranës dhe, pa datën 22.08.2014 dhënie e lejeve të ndërtimit është pezulluar me vendimin nr. 1, datë

22.08.2014. të Këshillit Kombëtar të Territorit, deri në konstituimin e organeve të reja përfaqësuese dhe ekzekutive të njësisë të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

Gjykata e Apelit çmon se, në të kundërt me sa pretendoi në ankim paditësi, refuzimi i palës së paditur, Bashkia Tiranë, për të dhënë lejet e kërkuara, ka qenë i ligjshëm.

Lidhur me lejet e ndërtimit për rikonstruksion banesë, për riparimin e çatisë së godinës së banimit dhe për shtesë banesë, refuzimi i palës së paditur është mbështetur në ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar), "Rregulloren uniforme të instrumenteve të planifikimit", miratuar me VKM nr. 481, datë 22.06.2011 (i ndryshuar) dhe "Rregulloren uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit", miratuar me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 (i ndryshuar).

Duke qenë, kërkesat e paditësit ndërhynin në strukturën e objektit ekzistues, për to nevojitej kërkesë për "Leje zhvillimore të veçantë", sipas nenit 70:7 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ndërsa, në lidhje me shtesën anësore kërkohet "Leje zhvillimore ndërtimi", sipas neni 70:5 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar).

Pala e paditur, e ka vënë në dijeni paditësin se, kërkesat për punime të cilat pajisen me leje zhvillimore ndërtimi nuk mund të shqyrtohen deri në hartimin dhe miratimin e Planit të Detajuar Vendor të nën njësisë strukturore 1/40, ku bënte pjesë ndërtesa e paditësit. Ndërkohë, këto lloj kërkesash për leje janë pezulluar me vendimin nr. 1, datë 22.08.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, deri në konstituimin e organeve të reja përfaqësuese dhe ekzekutive të njësisë të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015.

Në lidhje me punimet që nuk kërkonin leje, pala e paditur e ka orientuar paditësin që të plotësojë dhe të paraqesë pranë saj "Deklaratën për kryerje punimesh për mirëmbajtje", sipas neni 70/33 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në rrethanat e provuara në gjykim, mosveprim i palës së paditur, Bashkia Tiranë, nuk ka ardhur për faj të saj, por, nga njëra anë, për shkak të mosplotësimit të detyrimeve ligjore nga organet e tjera, si Këshilli Bashkiak, për miratimin e Instrumentin Vendor të Planifikimit dhe më pas të Planit të Detajuar Vendor, si dhe pezullimit të këtyre të fundit dhe lejeve të ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendimin e sipërcituar. Nga ana tjetër, nga mosplotësim i kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009, "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në fuqi nga paditësi, gjatë bërjes së kërkesave për punime të ndryshme në banesë.

Për më tepër, ashtu sic drejt ka arsyetuar gjykata e shka lës së parë, paditësi [REDAKTUAR] edhe pse i janë refuzuar kërkesat e tij për leje ndërtim, nuk i ka kundërshtuar gjyqësisht ato përpara juridiksionit gjyqësor administrativ. Në këto kushte, pretendimet e paditësit, duke mos u verifikuar gjyqësisht si të ligjshme, gjatë procesit gjyqësor të verifikimit të mosveprimit të organit publik, nuk mund të merren si të mirëqena dhe për pasojë duhen rrëzuar.

Gjykata e Apelit, duke konkluduar se në veprimet e palës së paditur, Bashkia Tiranë, nuk u konstatua sjellje e paligjshme kundrejt paditësit, Fiska Paha çmon sa pretendimet e tij të ngritura edhe në ankim për shkaktim dëmi pasuesor e jopasuesor janë të pazazuara dhe, në trjedhojë, të papranueshme.

Në analizë të sa u arsyetua *ut supra*, vendim i ankimuar, për sa ka disponuar, duhet të mbetet i pacenuar, çake u plotësuar motivet e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nga arsyetimi në këtë vendim i Gjykatës së Apelit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, germa "b" të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Lënie në fuqi të vendimit Nr. 3157, datë 11.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
2. Kundër vendimit rind të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, dake filluar nga e nesërnya e njoftimit të tij.

- U shpall në Tiranë, më 14.09.2018.

ANËTAR
BARI SHYTE
(d.v.)

ANËTARE
ALKEJINA GAZIDEDJA
(d.v.)

KRYESUES
AMARILDO LAÇI
(d.v.)

E njëjtë me origjinalin

